



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**

***Departamenti i Auditimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore***

Adresa: Rruga "Abdi Toptani" Nr.1 Tiranë. E-mail: [klsh.org.al](mailto:klsh.org.al); web-site [www.klsh.org.al](http://www.klsh.org.al)

Nr. 557/\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2019

**V E N D I M**

**Nr. 90, Datë 27.09.2019**

**PËR**

**AUDITIMIN E USHTRUAR NË BASHKINË PUKË “MBI AUDITIMIN FINANCIAR,  
TEMATIK”**

**(Për periudhën nga data 01.01.2018 deri më datën 31.12.2018)**

Në auditimin e ushtruar në Bashkinë Pukë me objekt: “Mbi auditimin financiar tematik për periudhën 01.01.2018 deri më 31.12.2019, mbi shkallën e zbatueshmërisë nga subjekti i rregullave, ligjeve dhe rregulloreve të raportimit financiar, rezultuan devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi (kriteret), të cilat në gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale (jo të përhapura), efektet e të cilave justifikojnë dhënien e një opinionit të kualifikuar. Fushat kryesore në të cilat janë konstatuar gabime, janë në pasqyrimin jo të saktë të disa llogarive në pasqyrat financiare e në hartimin dhe zbatimin e buxhetit në drejtim të ardhurave dhe shpenzimeve.

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Kryeaudituesit të Departamentit të mësipërm, Drejtori i Drejtorisë së Standardeve dhe Sigurimit të Cilësisë, si dhe Drejtori i Përgjithshëm (Drejtori i Auditit të Brendshëm shqyrtoi në emër të tij), në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30, të ligjit nr. 154/2014 miratuar në datën 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, me qëllim përmirësimin e gjendjes.

**VENDOSA:**

**I.**Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit në Bashkinë Pukë sipas programit të auditimit nr. 557/1, datë 13.08.2019, për periudhën 01.01.2018 - 31.12.2018.

**II.**Të miratoj Opinionin e auditimit dhe rekomandimet për përmirësimin e gjendjes dhe të kërkoj marrjen e masave sa vijon:

## OPINIONI I AUDITIMIT

### **Opinion mbi pasqyrat financiare**

Opinionin e dhënë mbi besueshmërinë e llogarive vjetore e mbështesim në konstatimet se; bilancet, deklaratat e të ardhurave, deklaratat e mbajtjes së të ardhurave, banka, janë përfshirë në deklaratat financiare. Janë marrë evidenca të mjaftueshme që të mund të japim një opinion. Deklaratat financiare janë paraqitur sipas ligjit të kontabilitetit dhe udhëzimeve të Ministrisë së Financave. “Sipas mendimit tonë, pasi kemi marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, mbështetur në standartet ISSAI 1700 shprehim një opinion të kualifikuar<sup>1</sup> për llogaritë vjetore të Bashkisë Pukë, duke arritur në përfundimin se anomali të apo rastet e mospërrputshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale por jo të përhapura, në llogaritë vjetore”.

### **Baza për opinionin mbi pasqyrat financiare.**

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Bashkisë Pukë, të vitit ushtrimor 2018, vlerat e paraqitura në postet e Formatit nr.1, Pasqyra e pozicionit financiar, Bilanci, krahasuar me vlerat e paraqitura në informacionet që jepen në formatet anekse si Formatit nr.2, Pasqyra e performancës financiare, ose pasqyra të ardhura e shpenzime, Formatit nr.3, Pasqyra e flukseve monetare (cash flow), Formatit nr.4, Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/Fondet neto, Formatit nr.5, Shënime shpjeguese për hartimin e raportimi pasqyrave financiare vjetore), Formatit nr.6, Pasqyra statistikore e investimeve dhe burimet e financimit, Formatit nr.7/a, Pasqyra gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike), Formatit nr.7/b, Pasqyra gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto), Formatit nr.8, Pasqyra statistikore dhe numrit të punonjësve dhe fondi i pagave.

Nën gjykimin profesional të audituesit, grupi i punës ka marrë në konsideratë prapën e materialitetit prej 2% (vlerën 4,939 mijë lekë për të ardhurat) për tu konsideruar, pasi gjatë kryerjes së testeve të kontrollit është arritur në përfundimin që sistemet e kontrollit të brendshëm kanë risk të ulët deri në të moderuar.

### **Përshkrimi i çështjeve:**

- Nga verifikimi i inventarëve kontabël rezultoi se janë azhornuar bruto të gjithë investimet e kryera për të gjithë aktivet brenda llojit sipas emërtesave të projekteve të investimeve pa i ndarë dhe përmbledhur në një vlerë të vetme totale për çdo aktiv. Për këto aktive mungojnë kartelat kontabël apo regjistri historik për çdo aktiv me të dhënat për veprimet ekonomike të kryera me to në vite si: viti i hyrjes, përshkrimin e aktivit, vlerën e blerjes, vlerën e shpenzimeve kapitale të kryera në vitet e mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vlerën e akumuluar të amortizimit dhe vlerën e mbetur

- Për vitin ushtrimor 2018 nuk është kryer kontabilizimi i veprimeve ekonomike për kontrata të lidhura për blerje mallrash apo projekte investimesh për vlerë të plotë të kontratës, as në momentin e mbërritjes së faturave. Efektet e veprimeve ekonomike dhe të ngjarjeve ekonomike të kryera nuk janë marrë në llogari në kohën e kryerjes së veprimit apo të ndodhjes së ngjarjes, por thjesht kur ndërhyr pagesa. Kështu nuk janë bërë regjistrimet kontabël në llog.231 “Shpenzime për investime për aktive afatgjata materiale” për 7 kontrata në vlerën 272,952,444 lekë të financuara nga FZHR, pra nuk janë kryer në kohën e lindjes të detyrimit

<sup>1</sup> Një opinion i kualifikuar jepet kur audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomali të apo rastet e mospërrputshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura, në llogaritë vjetore apo transaksionet në fjalë ose kur audituesi nuk është në gjendje për të marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit ku të bazojë opinionin, dhe efektet e mundshme mbi llogaritë vjetore apo transaksionet të kësaj pamundësie janë materiale por jo të përhapura.

për t'u paguar nga njësia ekonomike, detyrime këto që sjellin pagesa, dhe që kanë sjellë për ushtrimin e dhënë shpenzime.

Këto veprime nuk përputhen me parimet e kontabilitetit të pranuar, ligjit organik të buxhetit, si kërkesat e VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël” kapitulli III, pika 30., e Udhëzimit të MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” kreu I pika 8, Kreu II pika 15/a,b,c,18/a,b, Kreu III pika 32., me UMF nr. nr. 30 datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” kapitulli III, pika 28.. Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të institucioneve supreme të auditimit (ISSAI). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në paragrafin “Përgjegjësitë e audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare” të raportit tonë. Ne jemi të pavarur nga Subjekti, e theksuar kjo në ISSAI-n 10-Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30-Kodi Etik, në përputhje me kërkesat etike që janë të rëndësishme në auditimin pasqyrave financiare në Republikën e Shqipërisë, duke përfshirë Kodin e Etikës të KLSH dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin tonë.

#### **Përgjegjësitë e Drejtuesve të Bashkisë Pukë.**

Drejtimi i Bashkisë, është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e saktë të pasqyrave financiare në përputhje me kërkesat e ligjit “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe të Udhëzimit të Ministrisë Financiare nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”, kërkesat e tjera në kuadrin e raportimit financiar në fuqi, si dhe kontrollin e brendshëm që ka rezultuar i nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare, për të shmangur gabimet apo mashtrimet. Stafit drejtues është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara. Personat përgjegjës për drejtimin janë përgjegjës për kontrollin e procesit të raportimit financiar. Stafit drejtues është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi.

#### **Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH mbi Auditimin e Pasqyrave Financiare.**

Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi, nuk paraqesin anomalitë materiale, kështu si pasaktësi apo gabime që mund të kenë ekzistuar, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional në punën audituese.

Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale dhe i përshkruajmë ato në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

## **A. MASA ORGANIZATIVE**

**1. Gjetje nga auditimi:** Gjendja kontabël e aktiveve afatgjata materiale (në vlerën bruto) ta klasës 21 për vitin 2017 është në vlerën 3.356.915.085 lekë dhe për vitin 2018 është në vlerën 3.766.275.808 lekë, e cila është paraqitur e plotë, pasi janë pasqyruar të gjitha shtesat dhe pakësimet për çdo lloj grup aktiv. Inventari kontabël i aktiveve materiale gjendje në llogaritë: 210 “Toka, Troje, Terrene” është në vlerën 1,202,645 lekë; 211 “Pyje, Plantacione” në vlerën 15,700,355 lekë, 212 “Ndërtesa Konstrukione” në vlerën 561,791,720 lekë; 213 “Rrugë, rryte, vepra ujore” në vlerën 740.851,408 lekë; 214

“Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune” në vlerën 22,475,780 lekë nuk është i qartë në përcaktimet e emërtesave dhe vlerave të secilit aktiv, artikull për artikull, duke mos përcaktuar vlerën e plotë të çdo aktivi, e cila duhet të përfshijë vlerën fillestare dhe shtesat gjatë viteve të secilit aktiv. Në këto inventare janë azhornuar bruto të gjithë investimet e kryera për të gjithë aktivet brenda llojit sipas amërtesave të projekteve të investimeve pa i ndarë dhe përmbledhur në një vlerë të vetme totale për çdo aktiv.

Inventari fizik është kryer vetëm për aktivet e llogarive: 215 “Mjete Transporti” në vlerën 24,649,367 lekë; 218 “Inventar Ekonomik” në vlerën 70,834,942 lekë; 31 “Materiale” në vlerën 13,249,117 lekë; 32 “Inventari i imët ” në vlerën 14.321.569 lekë lekë, i cili rakordon me inventarin kontabël. Këto veprime janë në kundërshtim me VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël” Kapitulli I, pika 1. me Udhëzimin e MFE nr.8, datë 9.3.2018 ”Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” kreu I pika 8, Kreu II pika 15/a,b,c,18/a,b, Kreu III pika 32.

**1.1 Rekomandimi:** Drejtoria Ekonomike në Bashkinë Pukë të kryejë veprimet për krijimin dhe mbajtjen e një regjistri analitik aktiveve sipas formatit, ku duhet të përmbajë: datën e hyrjes ose marrjen në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, datën e daljes nga pronësia, në formë analitike.

**Brenda datës 31.12.2019**

**2. Gjetja nga auditimi:** Nga testimi i kontratave të investimeve rezultoi se: për 7 kontrata në vlerën **272,952,444 lekë** të financuara nga të ardhurat dhe nga FZHR, kontabilizimi i veprimeve ekonomike për kontrata të lidhura për blerje mallrash apo investimesh nuk është bërë për vlerë të plotë të kontratës, por në momentin e pagesave për fatura të mbërritura. Efektet e veprimeve ekonomike dhe të ngjarjeve të tjera ekonomike të kryera nuk janë marrë në llogari në kohën e kryerjes së veprimit apo të ndodhjes së ngjarjes, pra as në momentin e mbërritjes së faturës dhe as të celjes së fondeve. Pra regjistrimet kontabël janë kryer në momentin e kur është kryer pagesa dhe jo në kohën e lindjes të një detyrimi për t'u paguar nga njësi ekonomike, detyrime këto që sjellin pagesa, dhe që kanë sjellë për ushtrimin e dhënë shpenzime. Ky konstatim vlen për të gjitha rastet e lidhjes së kontratave me të tretët, të cilat nuk janë evidentuar në kontabilitet në vlerë të plotë, duke mos paraqitur vlerën e plotë të detyrimeve të lindura nga angazhimet financiare të krijuara nga lidhja e kontratave me të tretët.

**2.1. Rekomandimi:** Drejtoria Ekonomike në Bashkinë Pukë të kryejë veprimet e kontabilizimit për vlerë të plotë të kontratave për mallra e shërbime në momentin e nënshkrimit të tyre, duke pasqyruar të gjitha detyrimet financiare të lindura nga angazhimi i krijuar nga lidhja e kontratave të lidhura dhe jo thjesht kur ndërhyr pagesa, pasi evidentimi i saktë i detyrimeve ndaj të tretëve është i domosdoshëm për njohjen reale të borxhit të akumuluar dhe marrjen e masave për zvogëlimin gradual të tij.

**Menjëherë**

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i programimit, aprovimit, realizimit dhe monitorimit të buxhetit për vitin 2018, u konstatua se:

**a.** Mungojnë metodologjitë e planifikimit sipas produkteve dhe qendrave të kostos për shpenzimet dhe planifikim jo mbi baza reale të të ardhurave, të cilat ndihmojnë subjektet publike që jo vetëm të përlogarisin saktë nevojat për planifikim, por edhe të monitorojnë saktë dhe drejtë realizimin e objektivave të njësisë. Vetëm nëpërmjet aplikimit të këtyre metodave, Institucioni (dhe si pasojë palët e interesuara) mund të zbulojnë nëse aktivitetet e njësisë janë në linjë me qëllimet dhe objektivat strategjike të saj.

b. Buxheti për vitin 2018 paraqitet me një performancë jo të kënaqshme në lidhje me nivelin mesatar të realizimit të fondeve në masën 84 %, ku ka ndikuar realizimi në nivel të ulët të shpenzimeve operative në masën 59% dhe investimeve në masën 67%, ndërkohë që në datë 31.12.2018 detyrimet e papaguara janë në nivel të lartë në shumën 43,682,262 lekë ose në masën 10% të shpenzimeve totale të planifikuara..

c. Kryetari i Bashkisë për vitin 2018 janë përgatitur raporte 4-mujore për realizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve dhe krahasimi i tyre me planifikimin e buxhetit për çdo zë të tij sipas programeve të funksioni të kësaj njësie vendore, duke e paraqitur në Këshillin e Bashkisë. Këto raporte monitorimi janë raportuar vetëm në tregues tregues sasiore pa analizuar dhe shkaqet dhe përcaktuar masat korrigjuese për përmirësimin e situatës.

**3.1. Rekomandimi:** a. Strukturat drejtuese të këtij institucioni, në bashkëpunim me Grupet e Menaxhimit të Programeve dhe me strukturat që mbulojnë planifikimin dhe monitorimin e buxhetit, të përcaktojnë qartë në programimin e PBA, por dhe në planifikimin vjetor, mënyrat dhe metodologjinë e përlllogaritjes së kostos së aktiviteteve në bazë produktesh për çdo program me qëllim arritjen e objektivave dhe minimizimin e shmangieve nga këto objektiva. Procesi i planifikimit të buxhetit të kryhet në mënyrë të kujdesshme dhe të përgjegjshme me qëllim rritjen e transparencës, përgjegjshmërisë në përdorimin e fondeve publike si dhe përmirësimin e planifikimit dhe ekzekutimit të buxhetit të vitit koherent në arritjen e objektivave. Shpërndarja e fondeve buxhetore të bazohet në parashikimin e fluksit të hyrjeve të parasë dhe të angazhimeve dhe të sigurojë një përdorim eficient të burimeve financiare, si dhe të ruajë stabilitetin makroekonomik e fiskal.

b. Nevojitet të gjurmohet saktë dhe drejtë konsumimi i burimeve të nevojshme, duke synuar shpërndarjen e shpenzimeve (kostove) sipas aktiviteteve që i “shkaktojnë” këto kosto, me qëllim ndjekjen e kujdesshme të kostove për efekte buxhetore duke synuar minimizimin e rishpërndarjeve mes zërave buxhetore brenda vitit ushtrimor. Të rritet performanca e realizimit të buxhetit në nivel të kënaqshëm si për të të ardhurat në bazë reale dhe për shpenzimet në termat e produkteve, si dhe të merren angazhime për të marrë veprimet e duhura korrigjuese për të përmirësuar situatën dhe aty ku është e nevojshme të ndërhyhet.

#### Menjëherë

**4. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i transaksioneve financiare të kryera nëpërmjet bankës rezultoi se janë kryer pagesa me urdhër-shpenzime në 40 raste në vlerën 23,280,452 lekë mbi afatin 30 ditor të faturave për shpenzime mallra e shërbime dhe investime të mbërritura në institucion, ku një pjesë janë për shkak të kufizimit të limitit të arkës nga MFE për pagesat e vitit 2017 me shkresën nr.15973 datë 09.11.2017 dhe për pagesat e vitit 2018 me shkresën nr.19932 datë 07.11.2018.

**4.1. Rekomandimi:** Bashkia Pukë të marrë masa për sigurimin e likuiditeteve, në mënyrë që të mos ketë kufizime limiti të arkës për likuidimin e faturave në kohë, me qëllim që të mos akumulohet borxh për fatura të palikujduara dhe përfshirjen e institucionit në vështirësi financiare.

#### Menjëherë

### **D. MASA DISIPLINORE:**

#### **D.1. Për punonjësit që janë pjesë e shërbimit civil.**

**Shënim:** Në auditimin e mëparshëm për gjetjet e konstatuara për mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2017, KLSH me shkresën nr.1432/8, datë 19.08.2019 të dërgimit të Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe Rekomandimeve për auditimin e ushtruar nga grupi i Auditimit të KLSH për periudhën 01.01.16-31.12.2018, për **znj.F. P.** me detyrë Drejtore e Financës e Buxhetit dhe e Ndihmës Ekonomike në cilësinë e nëpunësit zbatues ka rekomanduar masa disiplinore: **a. “Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës**

për një periudhë deri në dy vjet”, neni 58 germa (c), si dhe masë administrative drejtuar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (dënim me gjobë) me shkresën 1432/11 datë 28.08.2019. Meqenëse rekomandimet për gjetjet e konstatuara në mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimin e PF të vitit 2017 janë përfshirë në planin e veprimit për realizim rekomandimesh të paraqitur nga Bashkia Pukë me shkresë 1/28 datë 12.09.2019, si dhe 2 nga rekomandimet kryesore (për kontabilizimin e Vendimit Gjyqësor të Shoqatës të Verbërve dhe korrigjimi i vlerës së amortizimit për mjetet e transportit) janë sistemuar dhe reflektuar në pasqyrat financiare të vitit ushtrimor 2018, **për këtë arsye nuk rekomandojmë masë.**

Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për masat e marra nga ana Juaj të përgatiten programe me afate dhe persona përgjegjës dhe për zbatimin e rekomandimeve të njoftohet Kontrolli i Lartë i Shtetit **brenda 20 ditëve** nga marrja e kësaj kërkesë.

Në vijim e në zbatim të nenit 30, pika 2 e këtij ligji, kërkohet ndjekja e realizimit të tyre në vazhdimësi duke nxjerrë aktet e nevojshme administrative dhe nisjen e procedurave disiplinore e administrative apo hartimin e padive gjyqësore për shpërblimin e demit dhe mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna, nga ana Juaj të raportohet (*me shkrim*) pranë Kontrollit të Lartë të Shtetit **brenda 6 muajve** nga marrja e njoftimit të Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe rekomandimeve.

**Bujar LESKAJ**

**K R Y E T A R**